

23753

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR. 23753 AKT

V E N D I M
PER
RREGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot me date 9/05/2000 une Gjyqtarja Altona Klokaj e Gjykates se Rrethit Tirane, pasi shqyrtova kerkesen dhe dokumentet e paraqitura nga Drejtori i Shoqerise "TV BALLKAN" Sh.A. Tirane, per rregjistrimin e saj si shoqeri tregtare dhe

K O N S T A T O V A :

1. "2K GROUP" SH.P.K. me Administrator z. Koco Kokedhima
2. HARRI LENA
3. ISUF FERRA

me cilesine e aksionereve te shoqerise "TV BALLKAN" sh.a., kane vendosur themelimin e shoqerise anonime "TV BALLKAN" sh.a.

Kapital themeltar i shoqerise eshte 50 000 000 (pesedhete milione) leke, i ndare ne 50 000 (pesedhete mije) aksione me vlere nominale 1000 leke secila te shlyera plotesisht nga aksioneret e siperpermendur dhe te zoteruara perkatesisht:

1. "2K GROUP" SH.P.K. me Administrator z. Koco Kokedhima zoteron 40 % (dyzet) te aksioneve.
2. HARRI LENA zoteron 40 % (dyzet) te aksioneve.
3. ISUF FERRA zoteron 20 % (njezet) te aksioneve.

Objekti i shoqerise eshte:

- Realizimi i transmetimeve te nje kanali televiziv nen emrin e kanalit "A 1"
- Prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimi i programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.
- Prodhimi dhe shumefishimi video i programeve, spektakleve, filmave, telenovelave, shperndarja dhe marketingu i tyre.
- Organizimi dhe realizimi ne bashkepunim me persona te tjere fizike dhe juridike i spektakleve, filmave, ndeshjeve sportive, emisioneve te ndryshme etj.
- Zhvillimi i teknologjive te informacionit, projektimi dhe ekzekutimi e rrjeteve dhe minirrjeteve, zhvillimi i testeve, publicitetit, prodhimi i spoteve etj.

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Aleksander Moisiu" Nr. 76 (prane Kinostudios), Tirane.

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.
Drejtor i shoqerise eshte z. Leonard Gremi.

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres te emeruar nga Asambleja e Aksionereve jane:

1. Mirela Qirjazi me cilesine e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres te "TV BALLKAN" SH.A.
2. Gjovalin Kola
3. Fotaq Bezati
4. Brixhida Kokedhima

Eksperti i pare Kontabel i Autorizuar eshte znj. Diana Golemi.

Dokumentacioni i paraqitur nga kerkuesi eshte i plote, kerkesa e bazuar ne ligj dhe si te tilla duhen pranuar.

PER KETO ARSYE:

Ne baze te nenit 24 te ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga shoqerite tregtare",si dhe te ligjit Nr. 7638,date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare",

V E N D O S A :

Rregjistrimin si person juridik te shoqerise anonime "TV BALLKAN" SH.A. te themeluar nga:

1. "2K GROUP" SH.P.K. me Administrator z. Koco Kokedhima qe zoteron 40 % (dyzet) te aksioneve.
2. HARRI LENA qe zoteron 40 % (dyzet) te aksioneve.
3. ISUF FERRA qe zoteron 20 % (njetzet) te aksioneve.

Kapital themeltar i shoqerise eshte 50 000 000 (pesedhjete milione) leke, i ndare ne 50 000 (pesedhjete mije) aksione me vlere nominale 1000 leke secila te shlyera plotesisht nga aksioneret e siperpermendur dhe te zoteruara si me siper.

Objekti i shoqerise eshte:

- Realizimi i transmetimeve te nje kanali televiziv nen emrin e kanalit "A 1"
- Prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimi i programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.
- Prodhimi dhe shumefishimi video i programeve, spektakleve, filmave, telenovelave, shperndarja dhe marketingu i tyre.
- Organizimi dhe realizimi ne bashkepunim me persona te tjere fizike dhe juridike i spektakleve, filmave, ndeshjeve sportive, emisioneve te ndryshme etj.
- Zhvillimi i teknologjive te informacionit, projektimi dhe ekzekutimi e rrjeteve dhe minirrjeteve, zhvillimi i testeve, publicitetit, prodhimi i spoteve etj.

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Aleksander Moisiu" Nr. 76 (prane Kinostudios), Tirane.

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat te pacaktuar.

Drejtor i Pergjithshem i shoqerise eshte z. Leonard Gremi.

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres te emeruar nga Asambleja e Aksionereve jane:

1. Mirela Qirjazi, me cilesine e Kryetarit te Keshillit Mbikqyres te "TV BALLKAN" SH.A.
2. Gjovalin Kola
3. Fotaq Bezati
4. Brixhida Kokedhima

Eksperti i pare Kontabel i Autorizuar eshte znj. **Diana Golemi**.

Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit.

Tirane me: 9/105/2000

GJYQTARE

(Handwritten signature)



AKT - THEMELIMI

I

SHOQERISE ANONIME "TV BALLKAN" SH.A.

Ne Tirane sot ne daten ___/05/2000, te meposhtmit:

1. **"2K GROUP" SH.P.K.**, rregjistruar si Person Juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane me Vendim Nr.19653 date 22.06.1998 me Administrator z. Koço Kokëdhima, i biri i Theodhoriut, lindur ne Qeparo me 21.04.1959, banues ne Tirane ne adresen: Rr. "Muhamet Gjollesha", Pall. 68;
 2. **HARRI LENA**, i biri i Fotos, lindur ne Gjirokaster, me 1961, banues ne Gjirokaster,
 3. **ISUF FERRA**, i biri i Ramazanit, lindur ne Tirane, me 1955, banues ne Tirane, ne adresen " Bulevardi Deshmoret e Kombit", Pall. 62/1,
- si themelues te Shoqerise Anonime "TV BALLKAN", ne te cilen ata jane aksionere, vendosen te hartojne kete **Akt Themelimi**, mbeshtetur ne parimet e meposhteme:

Neni 1

Themeluesit krijojne nje Shoqeri Anonime te cilen do ta quajne "TV BALLKAN" sh.a. Shoqeria do te kete formen e shoqerise anonime pa oferte publike, per sa kohe qe Asambleja e Aksionereve nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne nje shoqeri anonime me oferte publike.

Veprimtaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregetare", nga ky statut, ligji Nr. 8410 "Per Televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise" dhe nga legjislacioni ne fuqi. Aksionet zoterohen perkatesisht nga;

Neni 2

Emertimi i plote i shoqerise eshte **"TV BALLKAN" SH.A.** Te gjitha aktet e nxjerra nga shoqeria do te pasohen nga ky emertim.

Neni 3

Selia e shoqerise eshte ne adresen: **Rruga "Aleksander Moisiu" Nr. 76 (prane Kinostudios)**, Tirane.

Ajo mund te transferohet ne çdo vend tjeter me nje vendim te Keshillit Mbikqyres, me kusht qe ky vendim te miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese se Aksionereve.

Neni 4

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar te veprimtarise se saj, por sidoqofte mbi 10 vjet, duke filluar qe nga momenti i rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar, me perjashtim te rasteve kur shoqeria mbaron sipas parashikimeve ne ligj ose kur vendos Asambleja e Aksionereve.

Neni 5

Objekti i shoqerise "TV BALLKAN" SH.A. eshte:

- Realizimi i transmetimeve te nje kanali televiziv nen emrin e kanalit "A 1"
- Prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimi i programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjetër.
- Prodhimi dhe shumefishimi video i programeve, spektakleve, filmave, telenovelave, shperndarja dhe marketingu i tyre.
- Organizimi dhe realizimi ne bashkepunim me persona te tjere fizike dhe juridike i spektakleve, filmave, ndeshjeve sportive, emisioneve te ndryshme etj.
- Zhvillimi i teknologjive te informacionit, projektimi dhe ekzekutimi e rrjeteve dhe minirrjeteve, zhvillimi i testeve, publicitetit, prodhimi i spoteve etj.

Neni 6

Kapital themeltar i shoqerise eshte 50 000 000 (pesedhete milione) leke, i ndare ne 50 000 (pesedhete mije) aksione me vlere nominale 1000 leke secili, te numeruara nga 1 (nje) ne 50 000 (pesedhjet mije) te shlyera plotesisht nga aksioneret e siperpermendur. Ky kapital eshte i vlefshem per rregjistrimin e shoqerise.

Kapitali realizohet ne perputhje me perqindjet reciproke te pjesemarrjes se aksionereve ne shoqeri menjehere me nenshkrimin e kontrates., te zoteruara perkatesisht nga aksioneret :
Aksionet zoterohen perkatesisht nga;

1. **"2K GROUP" SH.P.K.**, qe zoteron 40 % (dyzet) te kapitalit themeltar te sh.a. "TV BALLKAN" ose 20 000 (njetete mije) aksione.
2. **HARRI LENA**, qe zoteron 40 % (dyzet) te kapitalit themeltar te sh.a. "TV BALLKAN" ose 20 000 (njetete mije) aksione..
3. **ISUF FERRA**, qe zoteron 20 % (njetzet) te kapitalit themeltar te sh.a. "TV BALLKAN" ose 10 000 (dhjete mije) aksione..

Neni 7

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 6 (gjashte) anetare. 4 (kater) prej tyre jane emeruar nga Asambleja Themeluese e Aksionereve. Ata jane:

1. **Gjovalin Kola**
2. **Mirela Qirjazi**
3. **Fotaq Bezati**
4. **Brixhida Kokedhima**

Dy anetaret e tjere te Keshillit Mbikqyres do te zgjidhen nga te punesuarit ne shoqeri konform dispozitave te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Kryetare e Keshillit te pare Mbikqyres eshte **znj. Mirela Qirjazi**.

Drejtori i shoqerise anonime "TV BALLKAN" SH.A. eshte z. **Leonard Gremi**.

Eksperti i pare kontabel i autorizuar eshte z. **Diana Golemi**.



Neni 8

Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqërisë rregullohet sipas dispozitave të legjislativës shqiptare, në bazë të statutit dhe këtij akti themelimi.

Neni 9


Shoqëria anonime "TV BALLKAN" sh.a. fillon veprimtarinë e saj me nënshkrimin dhe miratimin e dokumentave të saj themeluese.

THEMELUESIT


HARRI LENA

Harri Lena


PER "2 K GROUP" SH.P.K.
ADMINISTRATORI
KOÇO KOKEDHIMA

Koco Kokedhima


ISUF FERRA

ISUF FERRA




STATUTI

I SHOQERISE “TV BALLKAN” SH.A.

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

KRIJIMI I SHOQERISE

Shoqeria anonime me emertimin “TV BALLKAN” sh.a. krijohet ne baze te aktit te themelimit date __/05/2000 nga aksioneret e meposhtem:

1. **“2K GROUP” SH.P.K.**, rregjistruar si Person Juridik prane Gjykates se Rrethit Tirane me Vendim Nr.19653 date 22.06.1998 me Administrator z. **Koço Kokëdhima**, i biri i Theodhoriut, lindur ne Qeparo me 21.04.1959, banues ne Tirane ne adresen: Rr. “Muhamet Gjollesha”, Pall. 68.
2. **HARRI LENA**, i biri i Fotos, lindur ne Gjirokaster, me 1961, banues ne Gjirokaster
3. **ISUF FERRA**, i biri i Ramazanit, lindur ne Tirane, me 1955, banues ne Tirane,

Neni 2

FORMA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete formen e shoqerise anonime pa oferte publike, per sa kohe qe Asambleja e Aksionereve nuk do te marre nje vendim per shnderrimin e saj ne nje shoqeri anonime me oferte publike.

Veprintaria e shoqerise do te rregullohet nga dispozitat perkatese te ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 “Per Shoqerite Tregetare”, nga ky statut, ligji Nr. 8410 “Per Televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise” dhe nga legjislacioni ne fuqi.

Neni 3
PERSONALITETI JURIDIK

Kjo shoqeri fiton personalitetin juridik me rregjistrimin e saj ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane

Neni 4
EMERTIMI I SHOQERISE

Emertimi i plote i shoqerise eshte "TV BALLKAN" SH.A.
Ne te gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqeria emertimi i shoqerise do te ndiqet nga fjalet "Shoqeri Anonime" ose inicialet sh.a. duke treguar dhe shumen e kapitalit themeltar.

Neni 5
SELIA

Selia e shoqerise eshte ne adresen: **Rruga "Aleksander Moisiu" Nr. 76 (prane Kinostudios), Tirane.**


Ajo mund te transferohet ne çdo vend tjeter me nje vendim te Keshillit Mbikqyres, me kusht qe ky vendim te miratohet nga mbledhja me e afert e Asamblese se Aksionereve.

Neni 6
OBJEKTI

Objekti i shoqerise "TV BALLKAN" SH.A. eshte:

- Realizimi i transmetimeve te nje kanali televiziv nen emrin e kanalit "A 1"
- Prodhimi, transmetimi dhe ritransmetimi i programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit, te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablove, perseritesve, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.
- Prodhimi dhe shumefishimi video i programeve, spektakleve, filmave, telenovelave, shperndarja dhe marketingu i tyre.
- Organizimi dhe realizimi ne bashkepunim me persona te tjere fizike dhe juridike i spektakleve, filmave, ndeshjeve sportive, emisioneve te ndryshme etj.
- Zhvillimi i teknologjive te informacionit, projektimi dhe ekzekutimi e rrjeteve dhe minirrjeteve, zhvillimi i testeve, publicitetit, prodhimi i spoteve etj.

Neni 7
KOHEZGJATJA



Shoqeria ka nje kohezgjatje te pacaktuar te veprimtarise se saj, por sidoqofte mbi 10 vjet, duke filluar qe nga data e rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregetar. Ajo mund te perfundoje veprimtarine e saj ne cdo kohe me vendim te Asmblese se Jashtezakonshme te aksionereve ose sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Shoqeria pushon veprimtarine e saj si shoqeri anonime pa oferte publike konform dispozitave te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare" si dhe ne rastet e tjera te parashikuara nga ligji.

Neni 8

KAPITALI THEMELTAR

Kapital themeltar i shoqerise eshte 50 000 000 (pesedhjete milione) leke, i ndare ne 50 000 (pesedhjete mije) aksione me vlere nominale 1000 leke secili, te numeruara nga 1 (nje) ne 50 000 (pesedhjet mije) te shlyera plotesisht nga aksioneret e siperpermendur. Ky kapital eshte i vlefshem per rregjistrimin e shoqerise.

Aksionet zoterohen perkatesisht nga;

1. **"2K GROUP" SH.P.K.**, qe zoteron 40 % (dyzet) te kapitalit themeltar te sh.a. "TV BALLKAN" ose 20 000 (njezete mije) aksione.
2. **HARRI LENA**, qe zoteron 40 % (dyzet) te kapitalit themeltar te sh.a. "TV BALLKAN" ose 20 000 (njezete mije) aksione..
3. **ISUF FERRA**, qe zoteron 20 % (njezet) te kapitalit themeltar te sh.a. "TV BALLKAN" ose 10 000 (dhjete mije) aksione..

Neni 9

NDRYSHIMET E KAPITALIT THEMELTAR

I vetmi organ kompetent per ndryshimin e kapitalit eshte Asambleja e Aksionereve e cila merr vendim ne baze te raportit te Drejtorise qe permban treguesit e kerkuar nga ligji.

Kapitali themeltar mund te zmadhohet me te gjitha menytrat dhe modalitetet e kerkuara nga legjislacioni ne fuqi per kete qellim.

Ne perputhje me ligjin, aksioneret kane perpjestimisht me shumen e aksioneve te tyre, nje te drejte paresore ne nenshkrimin e aksioneve te emetuara per te kryer nje zmadhim te kapitalit. Ata mund te heqin dore nga kjo e drejte vetem individualisht.

Zvogelimi i kapitalit, ne te gjitha rastet i prek aksioneret ne te njejten mase ne perpjestim me vleren e aksionit qe zoterojne.


Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit do te behen konform dispozitave te percaktuara ne seksionin 6 me titull "Ndryshimi i Kapitalit Themeltar" te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

KREU II

AKSIONET DHE AKSIONERET

Neni 10

AKSIONERET E SHOQERISE





Aksioneret e shoqerise jane persona fizike dhe juridike qe kane vene ose do te vene ne zoterim aksione te shoqerise me te gjitha menytrat e parashikuara nga ligji dhe nga ky statut. Zoterimi i aksioneve te shoqerise u jep atyre te drejten te marrin pjese ne Asamble dhe ne votim ne perpjesetim me aksionet qe zoterojne.

Neni 11

TE DREJTAT DHE DETYRAT E AKSIONEREVE

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene e pergjithshme te aksionereve me kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe ky statut.

Votat qe zoterojne aksioneret jane proporcionale me perqindjet e aksioneve qe zoterojne.

Cdo aksioner i shoqerise ka te drejten e pjesemarrjes ne fitimet e shpermdashme te shoqerise ne perputhje me aksionet e tij sipas vleres nominale te zoteruar prej tij ne kapitalin e shoqerise.

Cdo aksioner ka te drejte te marre, kur eshte rasti, nje teprice nga likuidimi i kapitalit ne perpjesetim me vleren e aksioneve qe zoteron.

Aksioneret e shoqerise jane vete pergjegjies per deyrimet dhe per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne. Pergjegjësia tej kesaj mase eshte e ndaluar.

Te drejtat dhe detyrimet e permendura me siper ndjekin aksionin ne çfaredo forme qe ai te tjetersohet tek te tretet.

Neni 12

FORMAT E AKSIONEVE DHE LIBRI I AKSIONEVE

Aksionet jane te formes emerore.

Pronesia e aksioneve pasqyrohet ne librin e aksioneve, te mbajtur nga ana e shoqerise ose nga ndermjetesat financiare.

Libri i aksioneve do te permbaje ne çdo kohe: numrin dhe kategorine e aksioneve, daten e marrjes nga aksioneri, emrin, mbiemrin dhe adresen e çdo aksioneri si dhe vleren nominale per çdo aksion te zoteruar.

Secili aksioner ka te drejte te kerkoje me shkrim dhe te marre nje ekstrakt nga libri i aksionereve i cili vertetohet me vulen e shoqerise.

Secili aksioner ka te drejte te verifikojë nese emri i tij eshte futur ne librin e aksionereve dhe personi i cili mban librin eshte i detyruar t'i tregojë aksionerit me kerkesen e ketij te fundit, hyrjen perkatese ne liber.

Neni 13

TRANSFERIMI I PRONESISE SE AKSIONEVE

Aksionet e shoqerise jane lirisht te transferueshme vetem ndermjet aksionereve te shoqerise. Ne rast transferimi te aksioneve, asnje nga aksioneret nuk mund te zoteroje aksione qe perfaqesojne mbi 40 % te kapitalit themeltar.

Aksionet e shoqerise nuk jane lirisht te transferueshme tek te tretet.

Atë mund t'u shiten te treteve kur aksionet refuzohen te blihen nga aksionere te tjere te shoqerise. Ketij kushti i nenshtrohen edhe aksionet qe nenshkruhen ne rastin e zmadhimit te kapitalit te shoqerise.

Transferimi i aksioneve falas si rrjedhoje e trashegimnise kryhet duke respektuar legjislacionin ne fuqi.

KREU III

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 14

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asambleja e Aksionereve
2. Keshilli Mbikqyres
3. Drejtoria (Bordi Drejtues)

ASAMBLEJA E AKSIONEREVE

Neni 15

MBLEDHJA E ASAMBLESE SE ZAKONSHME

Asambleja e Aksionereve merr te gjitha vendimet te cilat jane te percaktuara nga ligji ose nga ky Statut.

Kjo Asamble do te mbahet detyrimisht ne 6 muajt e pare te çdo viti fiskal. Asambleja e Aksionereve mund te thirret perseri nese kjo do te konsiderohet e nevojshme dhe ne interes te shoqerise dhe nese jane plotesuar kushtet ligjore per nje mbledhje te tille.

Mbledhja e Asamblese njoftohet me ane te nje lajmerimi qe publikohet ne nje gazete te perditshme per jo me pak se 3 (tre) dite radhazi. Thirrja e Asamblese dhe njoftimi i aksionereve behet sipas kerkesave te nenit 132 dhe 133 te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare".

Mbledhjet e Asamblese se Aksionereve jane te vlefshme vetem kur ne to marrin pjese ose jane te perfaqesuar jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e aksionmbajtesve.

Vendimet e Asamblese se Zakonshme jane te vlefshme kur per to votojne zoteruesit e me shume se 1/2 (nje te dytat) te numrit te pergjithshem te aksioneve dhe vendimet miratohen me shumicen prej 1/2 (nje te dyten) e aksionereve te pranishem.


Kane te drejte te kerkojne thirrjen e mbledhjes se Asamblese se Aksionereve:

1. Drejtoria e Shoqerise
2. Eksperti Kontabel i Autorizuar
3. Aksionere qe zoterojne jo me pak se 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar
4. Nje mandatmbajtes i autorizuar nga gjykata ose nga likuiduesit

Neni 16

E DREJTA E VOTES



 Cdo aksioner perfaqeson vetem nje vote. Cdo aksioner mund te perfaqesohet nga nje aksioner tjetër i shoqerise ose nga bashkeshortja me ane te nje autorizimi per te cilin kerkohet nje forme e shkruar.

Neni 17
KRYETARI

Mbledhjet e Asamblese se Aksionereve drejtohen nga kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne mungese te tij, nga personi i parashikuar ne statut; perndryshe vete Asambleja zgjedh drejtues te mbledhjeve te saj.

Ne rast te thirrjes se Asamblese nga ekspertet kontabel te autorizuar, nga nje mandatmbajtes i autorizuar nga gjykata ose nga likuiduesit, mbledhja e Asamblese drejtohet nga personi ose njeri prej personave qe kane thirrur kete mbledhje.

Neni 18
ASAMBLEJA E JASHTEZAKONSHME

Asambleja e jashtezakonshme ka te drejte te ndryshoje Statutin me te gjitha dispozitat e tij. Asambleja e Jashtezakonshme eshte i vetmi organ kompetent qe vendos per ndryshimet e kapitalit themeltar.

Mbledhjet e Asamblese se Jashtezakonshme Aksionereve te sh.a. "TV BALLKAN" jane te vlefshme vetem kur ne to marrin pjese ose jane te perfaqesuar jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e aksionmbajtesve.

Vendimet e asamblese se Jashtezakonshme jane te vlefshme kur per to votojne zoteruesit e 1/2 (nje te dytat) te numrit te pergjithshme te aksioneve dhe vendimet miratohen me shumicen prej 3/4 (tre te katertat) e aksionereve te pranishem.

KESHILLI MBIKQYRES

Neni 19
PERBERJA

Keshilli Mbikqyres perbehet nga 3 anetare. Ata mund te jene persona fizike ose juridike te emeruar ne perputhje me dispozitat e ketij statuti si dhe ato te ligjit Nr. 7638 "Per Shoqerite Tregtare". Koha e ushtrimit te detyres per te gjithë anetaret eshte 4 vjet.

Anetaret e Keshillit Mbikqyres mund te japin doreheqjen nga detyra me ane te nje deklarate me shkrim e cila duhet t'i dergohet kryetarit te Keshillit Mbikqyres duke respektuar nje limit kohe prej dy javesh.

Shperblimi i anetareve te Keshillit Mbikqyres do te caktohet me Vendim te Asamblese se Aksionereve.

Neni 20
TE DREJTAT DHE DETYRAT



- Keshilli Mbikqyres kontrollon Drejtorine e shoqerise per plotesimin e detyrave te saj.
- Keshilli Mbikqyres ka te drejte te mbikqyre ne çdo kohe menazhimin e plote te Drejtorise se shoqerise dhe dokumentacionin e nevojshem.
- Keshilli Mbikqyres mund t'i propozoje Asamblese ndryshime ne statutin e shoqerise.
- Perveç kesaj, Keshilli Mbikqyres mund te kerkoje nje raport per problemet e shoqerise, marrdheniet ligjore dhe te biznesit me shoqerite qe ka lidhje si dhe per aktivitetet e biznesit qe jane sinjifikative per pozicionin e aksionmbajtesve.
- Keshilli Mbikqyres miraton rregulloren e brendshme mbi funksionimin e Drejtorise se shoqerise.

Do te kryhen nga Keshilli Mbikqyres:

- Percaktimi i numrit te anetareve te Drejtorise se shoqerise (bordi drejtues) dhe emerimi i tyre.
- Emerimi i nje anetari me cilesine e Drejtorit te Pergjithshem te Drejtorise.

Neni 21 ZGJEDHJA E KRYETARIT


Keshilli Mbikqyres zgjedh midis antareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes per kohen e ushtrimit te detyres se percaktuar ne nenin 21 te ketij statuti. Zgjedhja e tij behet ne mbledhjen e pare qe thirret pas Mbledhjes se Pergjithshme se aksionmbajtesve ne te cilen eshte zgjedhur ky keshill. Ne qofte se kryetari ose zevendesi i tij lirohen nga detyra para mbarimit te afatit, do te kryhet nje zgjedhje tjeter per periudhen e mbetur nga koha e ushtrimit te detyres se personave qe jane liruar. Ne pamundesi ardhjeje te kryetarit dhe zevendesit te tij gjate kesaj kohe, detyrat do te kryhen nga anetari me i vjeter ne moshe.

Keshilli Mbikqyres mund te caktoj rregulla te brendshme lidhur me proceduren e punes. Vendimet mund te nxirren vetem nga Keshilli Mbikqyres. Drejtoria e shoqerise mund te marre pjese ne mbledhjen e Keshillit Mbikqyres.

Neni 22 MBLEDHJET E KESHILLIT MBIKQYRES

Mbledhjet e keshillit Mbikqyres thirren me shkrim nga kryetari dhe ne pamundesi ardhjeje nga zevendesi i tij. Lajmerimi behet 15 dite perpara. Ne rast urgjence lajmerimi mund te behet brenda nje kohe me te shkurter dhe ftesa mund te komunikohet gojarisht, me telefon, teleks ose telegram. Ne kete ftese duhet te specifikohen rendi i dites dhe sugjerimet e vendimeve.

Ndonje anetar i Keshillit Mbikqyres mund te shtojte çeshtje ne rendin e dites te cilat duhet t'i behen te njohura kryetarit me ane te nje letre te pakten 10 dite para mbledhjes. Te gjithë anetaret e tjere te Keshillit duhet te informohen pa vonese mbi shtesat e rendit te dites.





Neni 23
MIRATIMI

Nese te gjithë anetaret e Keshillit Mbikqyres jane te ftuar ne kohen e duhur dhe nese te pakten gjysma e numrit legal te tyre merr pjese ne miratimin e nje rezolute, atehere Keshilli Mbikqyres formon nje quorum anetaresh qe duhet te jene prezent per te konsideruar nje mbledhje te vlefshme. Miratimi i nje rezolute e cila nuk ka qene e perfshire ne rendin e dites, eshte e lejueshme vetem nese asnje nga anetaret e pranishem te Keshillit Mbikqyres nuk e kundërshton rezoluten dhe te pakten dy te tretat e anetareve jane te pranishem.

Mbledhja do te drejtohet nga kryetari dhe ne rast se ai nuk eshte i pranishem nga zevendesi i tij. Kryetari vendos rradhen e rendit te dites, llojin dhe rradhen e votimit.

Vendimet mund te miratohen vetem nga mbledhjet e Keshillit Mbikqyres me shumicen e thjeshte me perjashtim te rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Kjo eshte e vlefshme dhe per votimin.

Ne rast barazimi votash do te ndermerret nje tjetër diskutim lidhur me çështjen konkrete vetem nese shumica e Keshillit Mbikqyres vendos per kete, perndryshe do te behet nje njoftim tjetër i menjehershëm. Nese dhe rezultati i votimit te dyte eshte i barabarte, atehere kryetarit i jepet e drejta e dy votave.

Procesverbalet e mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres si dhe Vendimet e dala prej mbledhjeve te Keshillit Mbikqyres, duhet te pergatiten dhe te nenshkruhen nga drejtuesi perkates i mbledhjes (kryetari ose ne mungese te tij zevendeskryetari).

Neni 24
INFORMACIONET KONFIDENCIALE

Anetaret e Keshillit Mbikqyres duhet te ruajne menyren e gjykimit dhe te veprimit ne lidhje me informacionin konfidencial dhe sekretet e shoqerise. Informacioni lidhur me shoqerine mund tu transferohet te treteve vetem me miratimin e kryetarit te Keshillit dhe me kusht qe transferimi nuk rrezikon interesat e shoqerise.

DREJTORIA E SHOQERISE

Neni 25
PERBERJA

- Shoqeria drejtohet nga nje drejtori e perbere nga disa anetare qe emerohen nga Keshilli Mbikqyres. Drejtori i Pergjithshem i shoqerise i emeruar nga Keshilli Mbikqyres perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet.

Neni 26
VOTIMI

Drejtorja do te hartoje rregulloren e funksionimit te saj e cila do te miratohet nga Keshilli Mbikqyres.



Vendimet e Drejtorise do te miratohen me shumice votash. Ne rast barazie votash, vota e kryetarit te Drejtorise do te jete percaktuese. Nese ai nuk eshte i pranishem atehere vota e zevendesit te tij mbetet deçizive.

Neni 27
DETYRAT E DREJTORISE

Drejtoria e shoqerise eshte e detyruar para shoqerise te respektoje kufizimet e percaktuara me ligj, statut dhe nga Keshilli Mbikqyres lidhur me hapesiren e autoritetit te tij drejtues.

KREU IV
TE NDRYSHME

Neni 28
LIKUIDIMI

Likuidimi i shoqerise vendoset nga Asambleja e Aksionereve kur per kete jane dakort aksioneret e pranishem ne kete mbledhje te Asamblese.

Vendimi i likuidimit te shoqerise duhet t'u behet i njohur te gjithe aksionereve te shoqerise nepermjet publikimit te tij ne mjetet e informacionit publik.



Procesi i likuidimit te shoqerise do te behet ne perputhje me dispozitat e seksionit V te ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregetare"

Neni 29
DISPOZITA TE FUNDIT

Per çeshtjet qe nuk parashikohen dhe rregullohen nga ky statut, vlejne dispozitat e ligjit Nr. 7638 date 19/11/1992 "Per Shoqerite Tregetare", te ligjit Nr. 8410 date 30.09.1998 "Per Televizionin Publik dhe Privat ne Republiken e Shqiperise" si dhe aktet e tjera ligjore qe rregullojne kete veprimtari.

AKSIONERET


HARRI LENA



PER "2 K GROUP" SH.P.K.

Administratori

KOÇO KOKEDHIMA



ISUF FERRA

ISUF FERRA

